



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 806/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Kleves Janku	Anëtar
Odisa Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.12.2017 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Shërbim i pastrimit, mbledhjen dhe transportimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçovë*” me Nr. REF 29588-10-12-2017, me fond limit 128.883.334 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 04.11.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kuçovë.
- Ankimues:** “Higjena” sh.p.k.
Rruga “Stiliano Thoma”, Kuçovë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kuçovë
Sheshi “18 Tetori”, Blloku “Tafil Skëndo”, Kuçovë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.10.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Shërbimi i pastrimit, mbledhjen dhe transportimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçovë*” me Nr. REF 29588-10-12-2017, me fond limit 128.883.334 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 18.10.2017, operatori ekonomik ankimues “Higjena” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kriteret e kualifikimit e konkretisht:

[...]

Në datën 13.10.2017 nga ana e AK Bashkia Kuçovë janë hedhur përsëri në sistemin elektronik DST për zhvillimin e procedurës së prokurimit të objektit: Shërbimi i Pastrimit, mbledhjen dhe transportimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçovë.

Ju bëjmë me dije sepse ashtu si në procedurën e mëparshme, edhe në këtë procedurë Ak është në kundërshtim me Ligjin dhe VKM e Prokurimeve Publike për shumë arsye, të cilat do ti rendisim më poshtë. Nga sa vërejmë ne si OE, është e dyta herë që AK përsërit të njëjtat gabime me dashje, ndoshta edhe më shumë, si për të ulur konkurrencën, për të anashkaluar shumë operatorë të kësaj fushe, me qëllimin e vetëm për të favorizuar të përzgjedhurin e saj për të fituar këtë tender. Edhe pse me një vendim nga ana juaj, Ak ka hequr konstatimet e bëra nga KPP, përsëri nuk i ka kushtuar rëndësi mënyrës se si hartohen DST me llogjikën ligjore dhe teknike, e cila duhet ndjekur kur harton DST.

Pikë së pari, Njësia e Prokurimit është përgjegjëse për hartimin e DST sipas Nenit 57 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se:

Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:

- përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;*
- hartimin e urdhërit të prokurimit;*
- përgatitjen e dokumentave të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kritereve të veçanta për kualifikimin dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;*

- 1. Kjo njësi ka hartuar DST në dy procedura, si në atë të muajit Korrik me fond limit prej 199 500 000 lekë dhe këtë të muajit Tetor me fond limit prej 128 883 334 lekë, të dyja për një afat kohor të kontratës për 4 vite. Ndryshe nga procedura e prokurimit, që u anulua nga KPP para dy muajsh, procedura e tanishme ka një diferencë prej 70 616 661 lekë më pak. Por, ajo që të habit dhe të skandalizon është fakti se megjithëse fondi limit tani është minus 70 616 661 lekë më pak se hera e parë, volume e punës, ditët e punës, specifikimet teknike, preventivat e shërbimit, analiza e kostos, kohështirja e kontratës, janë të njëjta në të dyja procedurat. Nga sa duket janë kopjuar nga DST e procedurës së parë dhe atje nuk ndyshon asnjë presje. Si mund të kuptohet që brenda një periudhe prej dy muajsh, po për të njëjta volume pune, të njëjta preventive dhe të njëjta kërkesa është ky ndryshim kaq i madh në çmim???*

Ndryshimi në fondin limit detyrimisht duhet të shoqërohet me ndryshimet në volume e punës dhe të pasqyrohen në të gjitha elementët e tjerë përbërës të strukturës së kostos.

Kush i harton këto materiale?

Kush mban përgjegjësi dhe sim und të justifikohet një shumë kaq e madhe lekësh prej 70 616 661, që pot e logaritet dhe tvsh shkon në 84 739 993 lekë?

Nuk e kuptojmë detyrën që ka kryer kjo njësi prokurimi apo vetëm se ka firmosur DST e servirura nga njerëzit e tjerë? Ku e ka zbatua Ligjin dhe VKM e prokurimeve kjo njësi?

Kush do të përgjigjetpër këtë shpërdorim detyre të mirëfilltë?

Si mund të abuzohet në këtë mënyrë më fondet publike?

Kërkojmë që kjo procedurë të anulohet dhe të llogariten tërësisht volume e punës dhe preventive përkatës në funksion te fondit limit. Gjithashtu kërkojmë, që njësia e prokurimit të kryejë detyrën në zbatim të Ligjit, me paanshmëri dhe pa e ndikuar nga interesa korruptive.

- Duke marrë shkas nga vlera e publikuar nga AK prej 38 665 000 lekë me TVSH për çdo vit të kontratës, përsëri si në procedurën e parë të anuluar prej KPP, ky fond nuk është i miratuar në Këshillin Bashkiak. Nga ka dalë kjo vlerë, pasi buxheti i vitit 2018 nuk është diskutuar dhe miratuar.*

Kërkojmë, që ky fond të rishikohet dhe të përcaktohet sipas Vendimit që do të marrë Këshilli Bashkiak për Buxhetin e vitit 2018.

- AK ka përcaktuar ndarje të barabartë në vlerën 38 665 000 lekë me TVSH në vitin 2018 dhe për të gjithë vitet e tjera kalendarike në vazhdim. Është shumë e pakuptueshme shtesa që bëhet në vlerën vjetore në vite në preventive për shtrirjen e shërbimit në Njësitë Administrative Kozare dhe Perondi. Pse në shpalljen elektronike të tenderit është afati i kontratës 4 vjet dhe në preventivat e mëposhtëm shprehet për 5 vjet? Apo dhe kjo nga keq kopjimi i DST?*



PREVENTIV

(Formulari i Çmimit të Ofertës)

Për shërbimin e pastrimit, grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave urbane për Bashkinë Kuçovë.

- | | |
|--|-------------------------------|
| <i>Autoriteti Kontraktor:</i> | - <i>Bashkia Kuçovë</i> |
| <i>Periudha e sipërmarrjes:</i> | - <i>Maksimumi 5 vjeçare</i> |
| <i>Volumet e punimeve janë për periudhën:</i> | - <i>1 vjeçare</i> |
| <i>Analizat dhe Çmimet njësi janë për periudhën:</i> | - <i>5 vjeçare</i> |
| <i>Fondi Limit Vjetor;</i> | - <i>26 515 904 (pa tvsh)</i> |

Viti 2017 e në vijim

<i>Nr.</i>	<i>Emertimi</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Çmimi/njesi</i>	<i>Dite pune/vit</i>	<i>Vlera</i>
<i>1.</i>	<i>Fshira me fshese dore e rrugeve dhe shesheve</i>	<i>m²</i>	<i>161 000</i>		<i>312</i>	
<i>2.</i>	<i>Fshirja me mjet teknologjik e rrugeve e shesheve</i>	<i>“</i>	<i>32 000</i>		<i>52</i>	

3.	<i>Grumbullim e transportim te mbeturinave urbane ne vend depozitim (per kontenier)</i>	<i>ton</i>	<i>19,7</i>		<i>312</i>	
		<i>cope</i>	<i>253</i>			
4.	<i>Larja e konteniereve metalike</i>	<i>“</i>	<i>60</i>		<i>48</i>	
5.	<i>Sherbimi i pastrimit ne EC-te publike te qytetit</i>	<i>“</i>	<i>4</i>		<i>312</i>	
6.	<i>Lagije rruge e sheshe me mjet teknologjik</i>	<i>m2</i>	<i>73 000</i>		<i>220</i>	
7.	<i>Heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit</i>	<i>dite</i>	<i>312</i>		<i>312</i>	
8.	<i>Ndarja e mbeturinave ne burim dhe sistemimi i tyre ne vend depozitim ne Fermen “Partizani”</i>	<i>“</i>	<i>312/120</i>		<i>216</i>	
	<i>Shuma</i>					
	<i>TVSH 20%</i>					
	<i>Shuma totale</i>					

V.O Per vitin 2017, ditët e punës do te përpjesëtohen ne raport me periudhën e mbetur te vitit 2017.

PREVENTIV

Viti 2018 – shtese e punimeve vjetore te parashikuara ne preventivin e mësipërm vjetor

Per sherbimin e pastrimit, grumbullimit dhe transportimit te mbeturinave urbane per bashkine Kucove (shtese qyteti Kucove dhe njesia Kozare).

<i>Nr.</i>	<i>Emertimi</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Çmimi/njesi</i>	<i>Dite pune/vit</i>	<i>Vlera</i>
1.	<i>Fshira me fshese dore e rrugeve dhe shesheve</i>	<i>m²</i>	<i>33 400</i>		<i>312</i>	
2.	<i>Fshirja me mjet teknologjik e rrugeve e shesheve</i>	<i>“</i>	<i>11 300</i>		<i>52</i>	
3.	<i>Grumbullim e transportim te mbeturinave urbane ne vend depozitim (per kontenier)</i>	<i>ton</i>	<i>2,9</i>		<i>104</i>	
		<i>cope</i>	<i>30</i>			
4.	<i>Larja e konteniereve metalike</i>	<i>“</i>	<i>45</i>		<i>12</i>	

5.	Lagije rruge e sheshe me mjet teknologjik	m ²	12 000		220	
6.	Heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit	dite	104		104	
ç.	Ndarja e mbeturinave ne burim dhe sistemimi i tyre ne vend depozitim ne	“	104		104	
	Shuma					
	TVSH 20%					
	Shuma totale					

Viti 2018 – shtese:

- rruge qe fshihen me fshese dore – 10 rruge – me sipërfaqe 33 400 m²- (312 dite pune/vit)
- rruge qe fshihen me autofshese – 3 rruge – me sipërfaqe 11 300 m² – (52 dite pune/vit)
- grumbullim + transportim i mbeturinave urbane – 2,9 ton/dite – 30 kont/dite - (104 dite/vit)
- larje e konteniereve metalike – 1 larje/kontenier/muaj (45 kont/dite.) – ose 12 dite/vit
- lagije e rrugëve e shesheve – 3 rruge – me sipërfaqe 12 000 m², - (220 dite/vit)
- heqje e mbetjeve solide nga pikat e grumb. dhe ambjente publike-3.5 ton/dite - (104 dite/vit)
- ndarje ne burim e mbeturinave dhe sistemim i tyre ne vend depozitim–0.6t/dite 104 dite /vit

PREVENTIV

Viti 2019 – shtese e volumeve te mesiperme

Per sherbimin e pastrimit, grumbullimit dhe transportimit te mbeturinave urbane per bashkine Kuçove (shtese njesia Perondi).

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi/njesi	Dite pune/vit	Vlera
1.	Fshira me fshese dore e rrugëve dhe shesheve	m ²	ç 200		312	
2.	Grumbullim e transportim te mbeturinave urbane ne vend depozitim (ner kontenier)	ton cope	4,2 45		156	
3.	Larja e konteniereve metalike	“	45		12	
4.	Lagije rruge e sheshe me mjet teknologjik	m ²	25 000		220	
5.	Heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit	dite	104		104	
6.	Ndarja e mbeturinave ne burim dhe sistemimi i tyre ne vend depozitim ne	“	104		104	
	Shuma					
	TVSH 20%					
	Shuma totale					

Viti 2019 – shtese:

- rruge qe fshihen me fshese dore – 4 rruge – me sipërfaqe ç 200 m²- (312 dite pune/vit)
- grumbullim + transportim i mbeturinave urbane – 4,2 ton/dite – 45 kont/dite - (156 dite/vit)
- larje e konteniereve metalike – 1 larje/kontenier/muaj (45 kont/dite.) – ose 12 dite/vit
- lagije e rrugeve e shesheve – 9 rruge – me sipërfaqe 25 000 m², - (220 dite/vit)
- heqje e mbetjeve solide nga pikat e grumb. dhe ambiente publike-3.5 ton/dite - (104 dite/vit)
- ndarje ne burim e mbeturinave dhe sistemim i tyre ne vend depozitim–0.8t/dite 104 dite /vit

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi/njesi	Dite pune/vit	Vlera
1.	Fshira me fshese dore e rrugeve dhe shesheve	m ²	161 000		312	
2.	Fshirja me mjet teknologjik e rrugeve e shesheve	“	32 000		52	
3.	Grumbullim e transportim te mbeturinave urbane ne vend depozitim (per kontenier)	ton cope	19,7 253		312	
4.	Larja e konteniereve metalike	“	60		48	
5.	Sherbimi i pastrimit ne ËC-te publike te qytetit	“	4		312	
6.	Lagije rruge e sheshe me mjet teknologjik	m ²	73 000		220	
ç.	Heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit	dite	312		312	
8.	Ndarja e mbeturinave ne burim dhe sistemimi i tyre ne vend depozitim ne	“	312/120		216	
	Shuma					
	TVSH 20%					
	Shuma totale					

Çmimet per njesi sipas analizave perkatese te kosos te ofruara nga OE.

Nr.	Emertimi	Njesia	Çmimi per njesi
			(pa tvsh)
1.	Fshirje me fshese dore e rrugeve dhe shesheve	1 m ²	
2.	Fshirje me mjet teknologjik e rrugeve dhe shesheve	1 m ²	
3.	Grumbullim dhe transportim mbeturina ne vend depozitim	1 kont.	
		1 ton	

4.	Larja e konteniereve metalike	1 cope	
5.	Sherbim pastrimi ne ËC – te publike te qytetit	1 ëc	
6.	Lagije rruge dhe sheshe me mjet teknologjik	1 m ²	
ç.	Heqje e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit	1 dite	
8.	Ndarja e mbeturinave ne burim dhe sistemimi i tyre ne vend depozitim ne Fermen “Partizani”		

Sipas preventivave të praqitura më sipër, AK parashtron shtesë në vitin 2018 Njësinë Kozare dhe në vitin 2019 Njësinë Perondi. Shtesa sipas preventivave me zërat e punës, parashikohet që në fillim të vitit, por kontratat ekzistuese të ish komunave përfundojnë për Kozare në Mars 2018 dhe për Perondinë në Prill të 2019. Detyrimisht Shërbimi I pastrimit deri në atë kohë do të kryhet sipas kontratave në vazhdim me kto dy ish komuna. Atehere si do të përfshihen shërbimet e këtyre dy Njësitë Administrative ne Kontratën e Re që AK po prokuron? Këto Njësi do të përfshihen sipas Marrëveshjes Kuadër (sepse në DST janë të kopjuara nga procedurat e mëparshme) apo do të prokurohen të ndara atëhere kur ato kontrata të përfundojnë?

AK në preventive ka bërë një ndarje aritmetike dhe jo një përllogaritje të mirëfilltë se sa do të shtohet fondi për çdo vit me të gjithë shërbimet shtesë të ish omunave që kërkon të realizojë.

Po prokurohet para përfundimit të kontratave ekzistuese një shërbim i cili vazhdon të kryhet.

A është e ligjshme kjo?

Nëse AK pretendon, që prokurimin për shërbimin ish komuna ta kryejë sipas planifikimit që ka bërë, atëherë duhet të përcaktojë saktë vlerën në lekë dhe volume dhe ditët e punës për çdo vit, sepse sipas parashikimit që ka paraqitur në preventivat shtesë për çdo vit, rritja e volumeve të punës në vite shkon deri në 35% më tepër se viti 2018. Atëhere si mund të ndahet fondi për çdo vit në mënyrë të barabartë kur volume e punës ndryshojnë dhe rriten nga viti në vit sipas preventivave të paraqitur?

Prandaj kërkohet që preventivat të ndryshohen dhe të paraqiten saktë për çdo vit. Shesat të pasqyrohen saktë në preventivat vjetore që dhe OE të jenë më të qartë në hartimin e ofertave.

4. Analizat e koston janë vetëm për Bashikë Kuçovë, kurse për Njësitë administrative nuk ka asnjë përllogaritje.

Kërkojmë që këto shtesa preventive të përllogariten me analizë siç është vepruar edhe për bashkinë Kuçovë.

5. Modeli i analizave të koston, të cilat i ka publikuar në DST dhe që janë orientuese për OE, janë jo të plota dhe ngatërruese për OE. Ato duhet të jenë sa më të sakta në elementët përbërës të çdo zëri shërbimi. Në disa analiza është përcaktuar numri i fuqisë punëtore, në disa jo. Duke ju refuar tabelës së publikuar nga ana e AK në DST kanë përcaktuar çmimin për njësi të grumbullimit të mbeturinave, e cila tregon pa përgjeshmëri dhe jo një vlerësim të procedurës nga ana e Njësisë së Prokurimit, e cila ka hartuar këto DST.

Kërkojmë që Analizat e Koston të saktësohen dhe në to të përfshihen edhe shtesat në ish komunat.

6. Duke ju referuar kritereve të veçanta të kualifikimit pika 4 ku thuhet se:
Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e shërbimit, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

e) Makineritë që duhet të disponojë shoqëria për realizimin e shërbimit, duhet të jënë të vit prodhimit minimalisht të v. 2003, duhet të jënë të plota dhe të pajisura me të gjithë aksesoret e nevojshëm e të mundshëm për të realizuar qëllimin dhe objektin e kontratave:

Makine teknologjike me kapacitet min. 9-10 ton	2 cope
Mjet transporti vetëshkarkues \geq 9-10 tone	2 cope
Autobot uji min. çt	1 cope

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 9-10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2003;
- b) Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2003, jo më pak se 1 (një) copë.
- c) Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo me të vogël se 5 m³. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2003. Jo më pak se 5 (pesë) copë
- d) Makina teknologjike përfshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m³, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2003;
- e) Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 7000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2003.

Ku bazohet AK, që përcakton vitin e prodhimit të mjeteve? Mbi cilin Ligj apo Vendim mbështete për të kërkuar vitin e prodhimit 2003? Ky është një kriter tepër diskriminues për OE pasi mjetet që qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë janë të paisur nga organet përkatëse më të gjitha dokumentacionin përfshirë edhe kontrollin teknik të tyre, conform rregullave dhe ligjeve të shtetit. Jetet e viteve më të hershme nuk mund ti nxjerrë bashkia nga qarkullimi. Ato bëhen vetëm me vendim të Qeverisë. Bashkia duhet të kërkojë karakteristikat e tyre, tonazhin dhe modelet përkatëse për të kryer shërbimet.

Kërkojmë që ky kufizim të hiqet si tepër diskriminues nga kërkesat e veçanta.

Sa më sipër vërehet se ka një ndryshim midis sasisë së mjeteve të kërkuara dhe llojeve të tyre.

- I. Në tabelë kërkohen 2 kamiona vetëshkarkues, në shpjegimet e mëpohtme kërkohen 5 mjete vetëshkarkues.
- II. Mjeti me platform nuk është kërkuar në tabelë si dhe nuk është as në specifikimet teknike dhe në preventive. Ky lloj mjeti është për të transportuar konteniere në parkun e OE për të kryer larjen e tyre, kurse AK ne specifikime dhe preventiv e ka larjen e konteniereve me mjet të veçantë teknologjik,
- III. Autofshesa është kërkuar 4-6 m3, kurese në specifikimet teknike është kërkuar me kapacitet 1-1.5 m3
- IV. Në preventive është përcaktuar larja e konteniereve me mjet teknologjik, AK nuk e ka kërkuar si mjet.

Nga sa shikojmë këto kërkesa janë kopjuar nga një procedurë tjetër dhe nuk janë bërë ndryshimet përkatëse nga ana e Njësisë së Prokurimit. Marim shkas nga fakti që AK kërkon makinë me platformë, që nuk me asnjë zëpunë në preventive, sepse këto mjete përdoren për transport kontenieresh nga pikat e grumbullimit në parkun e sipërmarrësit për të larë kontenieret dhe anasjelltas, ndërsa AK larjen e konteniereve e ka kërkuar të kryhet në vend dhe me automjet të veçantë teknologjik.

Po kështu edhe 5 makina vetëshkarkuese.

Kërkojmë ndryshimin e këtyre kërkesave dhe përshtatjen e tyre me specifikimet teknike dhe preventivat.

7. Bashkia është shprehur në kërkesa e veçanta se:

- Mjetet duhet të jene në pronësi dhe te jene te shënuara në regjistra publikë. OE duhet te paraqesë dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit taksat,
- Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore te blerjes.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shit-blerje ose kontrata dhurimi).

Nga kriteret e kopjuara në procedurat e tjera, AK është e paqartë për mse si do të paraqiten mjetet për këtë procedurë, edhe në vendimin e KPP 643/201ç, por edhe në VKM e Prokurimeve shrehet se AK duhet të jetë ëe qartë në kriteret që kërkon për të vërtetuar kapacitete teknike të operatorëve. Këto kriterëqë kanë kopjuar, janë konfuzë dhe shumënagtërruese. OE nuk e di se si duhet të vërtetojë kapacitetin teknik, që zotëron, si dhe sasië e këtyre mjeteve, që duhet të disponojë OE.

AK ka parashikuar vetëm që mjetet të jenë në pronësi dhe më poshtë shprehet me pira.

Kërkojmë që AK të jetë konkret, për sasinë e mjeteve dhe se si do ta vërtetojë OE posedimin e mjeteve (me pire, me kontratë pronësie, me Leasing etj).

AK për disponueshmërinë e konteniereve metalike është shumë e saktë për kërkesat që parashtron pëe OE. Pse dhe për mjetet nuk është vepruar kështu?

Kërkojmë që kjo kërkesë për mjetët të rregullohet njësoj si për kontenieret.

8. Në pikat 5 dhe 6 të kriterëve të veçanta thuhet se:

Operatorët ekonomikë ofertues që kanë patur marrëdhënie kontraktuale të mëparshme me ish njësitë vendore që përbëjnë Bashkinë Kuçovë dhe të cilët kanë rezultuar me mos përmbushje të suksesshme të objektit dhe detyrimeve përkatëse të kontratës, do të s'kualifikohen.

Operatori ekonomik ofertues nuk duhet të ketë detyrime të papaguara vendore, detyrime të ngarkuara nga organet kompetente audituese apo detyrime të ngarkuar nga organe të tjera në favor të Bashkisë Kuçovë dhe të Njësive Administrative (ish Komuna që i janë bashkuar Bashkisë Kuçovë). Mos përmbushja e këtij kriteri është shkak s'kualifikimi. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

AK në kriteret e mësipërme nuk ka kërkuar dokumente apo vërtetime se si OE do të vërtetojnë që nuk kanë detyrime apo mospërmbushje të kontratave. Si do të faktohen Këto detyrime?

Kërkojmë që këto kriterë të riformulohen dhe të shprehet konkretisht për vërtetimet që duhet të paraqesin OE në përmbushjen e tyre.

9. *Bashkia ka kërkuar çertifikata ISO 9001 14001 18001, por nuk ka kërkuar asnjë leje apo liçensë profesionale të OE, të cilat janë ndër pikat kryesore të këtyre çertifikimeve. Sugjerojmë që të shtohen liçencat profesionale në kriteret e veçanta të kualifikimit. OE fillimisht duhet të jenë të liçensuar në fushat përkatëse, në të cilat kryejnë biznesin dhe pastaj të çertifikohen nga organet e huaja.*

Kërkojmë që të vendosen lejet dhe liçencat profesionale përkatëse për shërbimin.

10. *Përsa i përket kërkesës që, OE duhet të dëshmojë që ka aftësi (çertifikata lëshuar nga një organ i akredituar), të përpunojë/ identifikojë/ trajtojë mbetjet metalike në fund të ciklit të jetës në përputhje me standardin EU 333/2011 (2008/98/EC) ose ekuivalent lëshuar nga agjensi çertifikimi (Në rastin e bashkimit të OE, secili duhet të disponojë këtë çertifikatë). Së pari, nëse do të referohemi rregulloreve, direktivave dhe udhëzimeve që dalin nga Parlamenti Europian, në Bruksel, atëherë gjëja e parë që do të kemi parasysh është që këto aplikohen për çdo vend anëtar i Bashkimit Europian. Parlamenti Europian për ta theksuar këtë gjë, në fund të çdo dokumenti që harton dhe publikon e specifikon këtë gjë. Vetëm duke u nisur nga kjo specifikë, duhet të pranojmë që Shqipëria dhe çdo subjekt shqiptar nuk mund të aplikojë këto direktiva, rregullre apo udhëzime, sepse janë hartuar vetëm për anëtarët e BE.*

Së dyti, kjo rregullore u referohet atyre subjekteve që do të eksportojnë skrap metalik prej alumini dhe hekuri në një nga vendet e BE dhe kjo procedurë prokurimi ka tjetër objekt. AK në DST kërkon që të bëhet ndarja në burim dhe sistemimi i mbeturinave në fushën e grumbullimit, pra ndarja e mbeturinave për riciklim dhe jo për të eksportuar skrap metalik apo alumini në vendet e BE.

Pra nëse një kompani do të eksportojë skrap metalik apo alumini si lëndë të parë për industrinë, duhet të përmbushë këto kriterë të përcaktuar në rregulloren nr. 333/2011.

Nëse i plotëson këto, atëherë ka të drejtë të eksportojë.

Prandaj e quajmë të pavend dhe absolutisht në kundërshtim me vetë rregulloren, aplikimin e një subjekti shqiptar të këtyre kritereve të parashtruara në këtë rregullore.

Kërkojmë që ky kriter të hiqet.

11. Përsa i përket konteniereve AK është shprehur në DST se:

Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 120 (njëqind e njetete) konteniere metalike ose zgjidhje ekuivalente me kapacitet minimal sipas sasise ditore qe do te evadohet, të jenë të papërdorura apo të paricikluara.

Disponueshmëria e tyre duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kontenieret në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar si dhe me faturat tatimore të blerjes.*
- b) Kontenieret e marra me qira financiare (leasing) apo të porositura duhet të shoqërohen me porosine (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes /afatin e ekzekutimit të porosisë (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi) si dhe faturat tatimore/ e transfertë bankarë për cdo porosi të kryer për sasinë minimale të kërkuar gjëndje.*
- c) Për Kontejnerët në pronësi, ose te porositur, Operatori ekonomik duhet të lejojë AK të kryejë verifikimin fizik te min. 30 % te sasise se kerkuar te konteniereve përgjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Në rast se Operatori ekonomik nuk i disponon kontenierët brenda periudhes së sipërcituar, do të s'kualifikohet.*
- d) OE nuk duhet ti kete ne perdorim/ instaluara keto konteniere ne funksion te realizimit te nje kontrate ne fuqi.*
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e konteniereve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit, shoqeruar me specifikimet teknike dhe pamje fotografike nga vendodhja e tyre, si dhe adresen e vendodhjes se tyre. Vendodhja e tyre duhet te jetë ne një nga ambientet ku OE ushtron aktivitetin tregtar (magazinë e vetë OE, magazina me qira, apo dhënie në ruatje tek të tretët (në këtë rast duhet ta konfirmojë me kontratë depozitimi dhe faturat e pagesës)*

Përsa i përket pikës (d) të këtij kriteri, theksojmë se është diskriminuese dhe aspak i nevojshëm, sepse ne si OE nuk mund ti nxjerrim jashtë përdorimit mjete mjetet dhe paisjet sa herë që Autoritetet zhvillojnë një procedurë dhe ne ti fillojmë kontratat me paisja dhe mjete të reja.

Kërkojmë që ky kriter të hiqet dhe të modifikohet.

12. Përsa i përket pikës që: OE duhet të plotësojë sipas kërkesave specifike të përcaktuara në Shtojcën Ekstra, Çertifikata për Oferta të Pavarura, konstatojmë se ne nuk kemi hasur në asnjë procedurë këtë shtojcë dhe nuk ekziston në DST që shpall APP. Kjo shtojcë plotësohet nga shtojca dhe deklaratat, të cilat janë në DST.

Kërkojmë që kjo shtojcë të hiqet.

Kërkojmë:

Të pezullohet procedura e prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës përfshirë edhe ankimimin në Komisionin e Prokurimit Publik

Të anulohet procedura e mësipërme, të saktësohen preventivat dhe volume e punës në vartësi të fondit limit që do të prokurohet si dhe ndarjes në vite.

Të merren parasysht të gjitha kërkesat tona për modifikimin dhe saktësimin e kritereve të veçanta.

II.3. Në datën 26.10.2017, nëpërmjet shkresës nr. 3340/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues (referuar informacionit të autoritetit kontraktor të paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik), duke e pranuar pjesërisht ankesën e paraqitur, ndërkohë që operatori ekonomik pretendon se nuk ka marrë përgjigje nga autoriteti kontraktor.

II.4. Në datën 27.10.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e depozituar pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 03.11.2017, nëpërmjet shkresës me nr.3529/1 prot., datë 03.11.2017, me objekt: “*Kthim përgjigje*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Higjena” sh.p.k.



pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Kjo njësi ka hartuar DST në dy procedura, si në atë të muajit Korrik me fond limit prej 199 500 000 lekë dhe këtë të muajit Tetor me fond limit prej 128 883 334 lekë, të dyja për një afat kohor të kontratës për 4 vite. Ndryshe nga procedura e prokurimit, që u anulua nga KPP para dy muajsh, procedura e tanishme ka një diferencë prej 70 616 661 lekë më pak. Por, ajo që të habit dhe të skandalizon është fakti se megjithëse fondi limit tani është minus 70 616 661 lekë më pak se hera e parë, volumet e punës, ditët e punës, specifikimet teknike, preventivat e shërbimit, analiza e kostos, kohështrirja e kontratës, janë të njëjta në të dyja procedurat. Nga sa duket janë kopjuar nga DST e procedurës së parë dhe atje nuk ndyshon asnjë presje. Si mund të kuptohet që brenda një periudhe prej dy muajsh, po për të njëjta volume pune, të njëjta preventive dhe të njëjta kërkesa është ky ndryshim kaq i madh në çmim???*”

Ndryshimi në fondin limit detyrimisht duhet të shoqërohet me ndryshimet në volume e punës dhe të pasqyrohen në të gjitha elementët e tjerë përbërës të strukturës së kostos.

Kush i harton këto materiale?

Kush mban përgjegjësi dhe si mund të justifikohet një shumë kaq e madhe lekësh prej 70 616 661, që po te logaritet dhe tvsh shkon në 84 739 993 lekë?

Nuk e kuptojmë detyrën që ka kryer kjo njësi prokurimi apo vetëm se ka firmosur DST e servitura nga njerëzit e tjerë? Ku e ka zbatua Ligjin dhe VKM e prokurimeve kjo njësi? Kush do të përgjigjet për këtë shpërdorim detyre të mirëfilltë?

Si mund të abuzohet në këtë mënyrë me fondet publike?

Kërkojmë që kjo procedurë të anulohet dhe të llogariten tërësisht volumet e punës dhe preventivat përkatës në funksion të fondit limit. Gjithashtu kërkojmë, që njësia e prokurimit të kryejë detyrën në zbatim të Ligjit, me paanshmëri dhe pa u ndikuar nga interesa korruptive;

si edhe me pretendimin “Duke marrë shkas nga vlera e publikuar nga AK prej 38.665.000 lekë me TVSH për çdo vit të kontratës, përsëri si në procedurën e parë të anuluar prej KPP, ky fond nuk është i miratuar në Këshillin Bashkiak. Nga ka dalë kjo vlerë, pasi buxheti i vitit 2018 nuk është diskutuar dhe miratuar. Kërkojmë, që ky fond të rishikohet dhe të përcaktohet sipas Vendimit që do të marrë Këshilli Bashkiak për Buxhetin e vitit 2018”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Autoriteti kontraktor në informacionin e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik sqaron se: “[...] Përlllogaritja e fondit limit është bërë bazuar në kriterin e udhëzimeve të Ministrisë së Financave për menaxhimin e sistemit buxhetor. Duke u nisur nga fakti se autoriteti kontraktor në rastin e parë kishte aplikuar marrëveshje kuadër, ku kishte planifikuar sasi të maksimale të nevojave për shërbime, në raport me analizën e bërë nga drejtoria e shërbimeve (e cila ka hartuar preventivat, analizat, etj, dhe jo njësia e prokurimit apo konsulenti që është bazuar në këto të dhëna). Dhe buxheti vetëm për zërat shërbime ka qenë planifikuar në bazë kontrata individuale dhe jo kontratë të vetëm. Këto kontrata kishin kohëzgjatje të ndryshme që tejkalonin kohëzgjatjen e marrëveshjes kuadër dhe ndaj fondi limit dilte më i lartë (se ky i parashikuar mbi bazën e PBA-së), por në asnjë rast kjo vlerë nuk kalonte për 50 muaj kontratë vlerën prej 149 mil lekë pa tvsh. Pjesa tjetër e fondit limit ishte parashikuar për edukim ambiental. Në këtë procedurë ky zë është hequr për shkak të mungesës së mbulimit me fonde të këtij zëri duke qenë se në këtë rast AK do të aplikojë kontratë klasike me kohëzgjatje 4 vjeçare bazuar në ligjin 68/2017 Për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe ligjit për transportin e mbetjeve. Në rast se ky shërbim do të përfshihet në këtë kontratë, atëherë AK do të marrë në mënyrë të padrejtë këto kosto të cilat që në fillim të procedurës nuk i ka të siguruar sikurse ka ndodhur me kontratat e trashëguara ku operatori ankimes është palë (ku kohëzgjatja e kontratave është në tejkallim të afateve dhe planifikimeve buxhetore të njësive respektive). Në procedurën e parë AK kishte mundësinë me marrëveshjen kuadër të planifikonte edhe shërbime edhe fonde pa pasur nevojën për të patur planifikim në PBA, pasi ishte vetë instrumenti që e lejonte atë dhe nuk e detyronte AK të angazhonte fonde buxhetore (për shkak se do të aplikonim MK). Por të detyruar nga vendimmarrja e KPP konkludua se zërat dhe sasi të parashikuara janë dhe konsiderohen si kontrata tipike pasi janë të përcaktuara ndonëse kishim parashikuar në DST që këto sasi janë referuese.

Në këto kushte për shkak të mbrojtjes së interesit publik për arsye se në PBA nuk ka pasur zë edukim qytetar ambiental, nuk mund të parashikohet në këtë kontratë, pasi do të detyronte AK të merrte përsipër angazhime të cilat dalin përtej aftësive paguese të tij. Bazuar në studimin e kryer nga drejtoria e shërbimeve dhe vlerave vjetore/sasive vjetore për çdo njësi vendore del kjo përlllogaritje e fondit limit:

	2 m	12 m	12 m	12 m	12 m
	2017	2018	2019	2020	2021
Kuçova	2209658.7	26515904	26515904	26515904	26515904
Kozara		3752409	4502890	4502890	4502890
Perondi			2918309.3	4119966	4119966
	Nëse aplikohet				
	2209658.7	30268313	33937103	35138760	35138760

Fillimi i shërbimeve që mbulohen nga kontratat ekzistuese në fuqi do të jenë sipas këtij kalendari:

Kozarë 01.03.2018

Kuçovë Menjëherë

Perondi 15.04.2019

Pra në total 134482936,3 pa tvsh bazuar në përlllogaritjen e drejtorisë së shërbimeve. Fondi është nxjerrë bazuar në PBA dhe përlllogaritjes e AK (struktura buxhetore përkatëse e cila ka një ulje në një vlerë të përafërt prej 6 milion lekë pra e papërfillshme në kuadër të cilësisë së shërbimit që mund të korrektohet sipas standarteve ligjore në fuqi përgjatë zbatimit të kontratës (me ulje sasi ose shtesë fondi)[...];

[...] Vlera vjetore e përcaktuar është parashikuar në shërbimet e kryera në të kaluarën bazuar në sasitë e parashikuara në këtë kontratë, por referuar kostove historike sipas udhëzimit të ministrisë së financave për përgatitjen e PBA”.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në seksionin Njoftimi i Kontratës, rezulton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se “PBA për çdo vit kalendarik duke filluar nga viti 2018 është 38.665.000 lekë me TVSH për çdo vit”.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të publikuar për këtë procedurë prokurimi, referuar arsytimit dhe argumentave të paraqitura nga ana e autoritetit kontraktor, rezulton se, zëri “edukim ambiental” nuk është parashikuara në këto dokumenta të publikuara në datën 13.10.2017.

III.1.3. Në nenin 12 pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij”.

III.1.4. Në nenin 19/1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj”

Në nenin 63 pika 1 dhe 1.1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se:

Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Në nenin 64 pika 3 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se:

Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;

b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;

c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;

ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.

III.1.5. Në nenin 28 pika 1 dhe 2 të Vendimit nr. 184, datë 17.03.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar” parashikohet se :

1. Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar:

a) Pushimin e procedimit administrativ për shkak se veprimet e treguara në ankesë nuk përbëjnë shkelje të legjislacionit mbi prokurimin publik apo kur pretendimet e ankuesit rezultojnë të paprovuara; ose

b) Ndalimin e autoritetit kontraktor të vazhdojë veprimet e paligjshme, duke i caktuar një afat kohor.

2. Nëse Komisioni vendos sipas pikës 1 shkronjës “b” të këtij neni me arsyetimin se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ligjin 9643/2006, dhe kontrata e prokurimit ende nuk është lidhur, atëherë Komisioni ka të drejtë:

a) Të interpretojë rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, duke udhëzuar autoritetin kontraktor të veprojë sipas këtij interpretimi në vazhdimin e procedurës së prokurimit;

b) Të anulojë plotësisht ose pjesërisht vendimin ose veprimin e autoritetit kontraktor të nxjerrë në kundërshtim me ligjin, si dhe të udhëzojë vazhdimin e procedurës së prokurimit në përputhje me ligjin, duke treguar veprimet që duhet të kryhen në vijim;

c) Të konstatojë shkeljen ligjore konkrete dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor mbi korrigjimin e tyre, si dhe për vazhdimin e procedurës së prokurimit;

d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor për rifillimin e procedurës së prokurimit.

Në nenin 57, pika 2 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:

- *sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;*
- *përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti);*
- *përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;*
- *hartimin e urdhrit të prokurimit;*
- *përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;*
- *hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;*
- *administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;*
- *llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti.”*

III.1.6. Në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Vlera limit e kontratës publike është shuma totale, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit. Në llogaritjen e vlerës merret parasysh edhe shuma totale që duhet paguar në rast ripërtëritjeje të kontratës, kur një rasti tillë është parashikuar. Kjo vlerë ka për qëllim klasifikimin e kontratës sipas kufijve monetarë dhe planifikimin e publikimin e procedurës së prokurimit. Vlera e TVSH-së llogaritet si zë më vete, por nuk përfshihet në vlerën limit të publikuar në njoftimin e kontratës. TVSH-ja, kur është e zbatueshme, i shtohet vlerës së ofertës fituese për llogaritjen e vlerës totale të kontratës që do të lidhet.*

2. Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar. Në rastet e kontratave të furnizimit të mallrave, përmes qirasë apo leasing, fondi limit llogaritet duke përfshirë qiranë apo këstin mujor, shumëzuar me numrin e muajve, gjatë të cilave do të zgjatë kontrata”.

III.1.7. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është autoriteti kontraktor organi përgjegjës për përcaktimin e nevojave të tij për mallra, shërbime e pune, duke përcaktuar për secilën prej tyre sasi të përkatëse dhe të duhura sipas nevojave të tij, specifikimet teknike të tyre, preventivin me llojin e mallit/shërbimit/punës pra duke përcaktuar zërat përkatës, e në vijim të tyre duke përcaktuar edhe fondin limit për një objekt të caktuar prokurimi. Pra është përgjegjësi e autoritetit kontraktor, si organi me interes të drejtëpërdrejtë për kryerjen e procedurës së prokurimit, si edhe organi përgjegjës për mirëpërdorimin e fondeve publike, të përcaktojë fondin limit të një procedure prokurimi, në përputhje me sasi të domosdoshme për plotësimin e nevojave të tij.

Në këto kushte, nisur edhe nga argumenti i autoritetit kontraktor, se në këtë procedurë se është ndryshuar preventivi duke u hequr zëri i edukimit ambiental, zë i cili ka ndikuar edhe në ndryshimin e fondit limit, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar dhe provuar me dokumentacion, duke bërë një përlllogaritje të saktë të fondit limit, në varësi të volumeve të punës dhe të zërave të kërkuar si të domosdoshëm për këtë shërbim (në rastin konkret se sa peshë zë elementi “edukim ambiental”, mbi bazën e të cilit autoriteti kontraktor argumenton se për shkak të heqjes së këtij zëri vjen edhe ky ndryshim shumë i madh në fondin limit).

III.1.8. Në vendimin KPP 643/2017, datë 06.09.2017 në pikën III.4. të pjesës Arsyetoi ka gjykuar në lidhje me fondin limit të kësaj procedure, e cila ka qenë publikuar për t’u zhvilluar në datën 05.08.2017. Referuar vendimit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, referuar edhe korrespondencës zyrtare me institucionet përkatëse financiare, rezulton se fondi limit në dispozicion të këtij institucioni është në shumën 139.042.563 lekë me tvsh për katë vite, pra për vitet 2017, 2018, 2019, 2020, ndërkohë që në sqarimin e dhënë nga autoriteti kontraktor sipas tabelës së mësipërme fondi limit është parashikuar për 5 vite (2017-2021).

Referuar shkesave zyrtare nga organet financiare të cilat kanë sqaruar të detajuar vlerën e fondit limit për secilin vit deri në vitin 2020, rezulton se fondi limit i miratuar në dispozicion të Bashkisë Kuçovë është më i vogël se fondi limit i publikuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi. Nga vetë autoriteti kontraktor ka informacione kontradiktore në lidhje me fondin limit dhe përlllogaritjen e tij, aq më tepër që prej tij nuk është dhënë asnjë dokument, fakt apo provë në lidhje me fondin, mënyrën e përcaktimit të tij për secilin vit sipas zërave dhe volumeve të punës të cilat nuk janë të njëjta për secilin vit, e rrjedhimisht edhe fondi limit nuk mund dhe nuk ka sesi të jetë i njëjtë për secilin vit respektiv. Gjithashtu, nga ana e autoritetit kontraktor nuk jepet asnjë fakt në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi miratimin e buxhetit të vitit 2018 me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, pamjaftueshmëria e mbulimit me fonde publike çënon në thelb zbatimin e kontratës publike. Në nenin 76, pika 1 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se “Autoriteti kontraktor, për fondet buxhetore, prokuron kontratat për një periudhë deri në mbylljen e vitit buxhetor, përveç rasteve kur lidhen kontrata shtesë, në përputhje me shkronjën “b”, të pikave 3 e 5, të nenit 33 të LPP. Në çdo rast, financimi i kontratave të prokurimit bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.” Gjithashtu, kjo bie në kundërshtim edhe me parashikimet e Udhëzimit nr.2, datë 6.2.2012 të Ministrisë të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. Sa më sipër, autoriteti kontraktor, duhet të bëjë një përlllogaritje dhe ndarje të saktë të zërave dhe volumeve të punës për secilin vit, e në varësi të tyre të përlllogarisë fondin limit, për të cilin duhet të ketë marrë paraprakisht miratimin nga organet përkatëse financiare (Ministria e Financave, institucionet e thesarit etj) si edhe të ketë miratua me vendim të Këshillit Bashkiak buxhetin përkatës që nevojitet për këtë shërbim kaq të rëndësishëm për qytetin.

Rrjedhimisht, sa më sipër analizuar, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “[...] AK ka përcaktuar ndarje të barabartë në vlerën 38 665 000 lekë me TVSH në vitin 2018 dhe për të gjithë vitet e tjera kalendarike në vazhdim. Është shumë e pakuptueshme shtesa që bëhet në vlerën vjetore në vite në preventive për shtrirjen e shërbimit në Njësitë Administrative Kozare dhe Perondi. Pse në shpalljen elektronike të tenderit është afati i kontratës 4 vjet dhe në preventivat e mëposhtëm shprehet për 5 vjet? Apo dhe kjo nga keq kopjimi i DST? [...]

Sipas preventivave të paraqitura më sipër, AK parashtron shtesë në vitin 2018 Njësinë Kozare dhe në vitin 2019 Njësinë Perondi. Shtesa sipas preventivave me zërat e punës, parashikohet që në fillim të vitit, por kontratat ekzistuese të ish komunave përfundojnë për Kozare në Mars 2018 dhe për Perondinë në Prill të 2019. Detyrimisht Shërbimi i pastrimit deri në atë kohë do të kryhet sipas kontratave në vazhdim me këto dy ish komuna. Atëherë si do të përfshihen shërbimet e këtyre dy Njësitë Administrative në Kontratën e Re që AK po prokuron? Këto Njësi do të përfshihen sipas Marrëveshjes Kuadër (sepse në DST janë të kopjuara nga procedurat e mëparshme) apo do të prokurohen të ndara atëherë kur ato kontrata të përfundojnë?

AK në preventive ka bërë një ndarje aritmetike dhe jo një përlllogaritje të mirëfilltë se sa do të shtohet fondi për çdo vit me të gjithë shërbimet shtesë të ish komunave që kërkon të realizojë.

Po prokurohet para përfundimit të kontratave ekzistuese një shërbim i cili vazhdon të kryhet.

A është e ligjshme kjo?

Nëse AK pretendon, që prokurimin për shërbimin në ish komuna ta kryejë sipas planifikimit që ka bërë, atëherë duhet të përcaktojë saktë vlerën në lekë dhe volume dhe ditët e punës për çdo vit, sepse sipas parashikimit që ka paraqitur në preventivat shtesë për çdo vit, rritja e volumeve të punës në vite shkon deri në 35% më tepër se viti 2018. Atëherë si mund të ndahet fondi për çdo vit në mënyrë të barabartë kur volume e punës ndryshojnë dhe rriten nga viti në vit sipas preventivave të paraqitura?

Prandaj kërkojmë që preventivat të ndryshohen dhe të paraqiten saktë për çdo vit. Shtesat të pasqyrohen saktë në preventivat vjetore që dhe OE të jenë më të qartë në hartimin e ofertave”;

“Analizat e kostos janë vetëm për Bashkinë Kuçovë, kurse për Njësitë administrative nuk ka asnjë përlllogaritje. Kërkojmë që këto shtesa preventive të përlllogariten me analizë siç është vepruar edhe për bashkinë Kuçovë”;

“Modeli i analizave të kostos, të cilat i ka publikuar në DST dhe që janë orientuese për OE, janë jo të plota dhe ngatërruese për OE. Ato duhet të jenë sa më të sakta në elementët përbërës të çdo zëri shërbimi. Në disa analiza është përcaktuar numri i fuqisë punëtore, në disa jo. Duke ju refuar tabelës së publikuar nga ana e AK në DST kanë përcaktuar çmimin për njësi të grumbullimit të mbeturinave, e cila tregon pa përgjeshmëri dhe jo një vlerësim të procedurës nga ana e Njësisë së Prokurimit, e cila ka hartuar këto DST. Kërkojmë që Analizat e Kostos të saktësohen dhe në to të përfshihen edhe shtesat në ish komuna”

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Autoriteti kontraktor në informacionin drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik sqaron se: “[...] Në lidhje me afatin ky është një gabim i autoritetit kontraktor dhe të bëhet korigjimi në 4 vjeçar. Në lidhje me preventivat e vitit 2018 dhe 2019, shtesa që i përkasin komunave Kozarë dhe Perondi ato janë konsideruar nga KPP si të sakta dhe janë elementë përse AK ka operuar edhe në këtë rast ashtu sikundër edeh ju.

Kjo vlerë nuk ndikon në kontratat ekzistuese (ku ju jeni palë), pasi AK do të ndjekë strategji të tjera likuidimesh/planifikimi buxhetor të detyrimeve që vijnë nga kontratat ekzistuese. Në çdo rast mekanizmi i përcaktimit të shërbimeve rast pas rasti (pra në çdo vit me rinovimet vjetore) siç është aplikuar deri më tani është një element sigurie, pasi AK në çdo rast do të ketë të drejtën e rishikimit të sasive;

“[...] Analiza e kostos është parashikuar për Bashkinë Kuçovë në tërësi (Bashkia Kuçovë i përfshin të gjitha njësitë administrative) dhe ajo është referuese në çdo rast. Shërbimet janë zëra të njëjtë AK nuk mund të kërkojë analizë fikse pasi ato janë metodologji të ndryshme dhe aplikohen nga OE në bazë të njohurive dhe formimit që kanë në forma të ndryshme”;

“Modeli i analizës së kostos është orientuese dhe parashikon minimumin e kërkesave rast pas rasti (struktura). Për zërat që AK nuk ka përcaktuar kërkesa atëherë është e drejtë e operatorit ekonomik të bëjë vetë përzgjedhjen. Ajo që duhet kuptuar është që metodologjia duhet të nxjerrë saktë vlerën e përlogaritur (pavarësisht se metodologjia do të jetë një përzgjedhje e lirë e vetë OE bazuar në standartin minimal të AK).

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik në fuqi, përcaktimi i kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, si edhe përcaktimi i specifikimeve teknike, preventivave përkatës me zërat dhe elementët e duhur, duhet të jetë i saktë, i qartë, në mënyrë që edhe operatori ekonomik të bazohet në të dhëna të saktë gjatë hartimit të ofertës së tij.

III.2.3. Në lidhje me afatin e kësaj kontrate, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e këtij pretendim me arsyetimin se është bërë një lapsus që është përshkruar në dokumentat e tenderit që afati është 5 vjeçar, por që ky fakt nuk është reflektuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e autoritetit kontraktor (shtojcë e dokumenteve të procedurës së prokurimit) në lidhje me vendimarrjen e AK. Megjithatë, Komisioni i Prokurimit Publik nuk mund të anashkalojë faktin se pretendimi i mësipërm është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor dhe në lidhje me këtë të fundit nuk ka më objekt ankimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, por në zbatimin e këtij vendimi të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor, krahas konstatimeve të vendimarrjes së K.P.P. duhet të pasqyrojë njëherazi edhe ndryshimet e dokumenteve të procedurës së prokurimit për aq sa është pranuar prej autoritetit kontraktor.

III.2.4. Në lidhje me preventivat, analizën e kostos, si edhe modelin e analizës së kostos, në dokumentat e tenderit Specifikimet teknike, në pikën 7.4. Rregulla për t'u zbatuar, pika 6, është përcaktuar: *“Në ofertë OE duhet të paraqesë një analizë të ofertës së tij bazuar në formatin me kërkesat e analizës së Bashkisë. Në çdo rast përgjatë zhvillimit të procedurës AK rezervon të drejtën të kërkojë sqarime në lidhje me mënyrën e ndërtimit të ofertës së OE, pavarësisht nëse oferta e tij, rezulton ose jo anomalisht e ulët në lidhje me mënyrën e ndërtimit të tij, analizën, dokumentat mbështetëse, si pasqyra financiare, llogari, libra kontabël”.*

Gjithashtu në dokumentat e tenderit, në specifikimet teknike, janë përcaktuar analizat e kostos me përshkrimet përkatëse për Bashkinë Kuçovë.

Referuar sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, lidhur me preventivat për secilin vit, analizën e kostos, modelin e analizës së kostos, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të reflektojë duke bërë ndryshimet dhe modifikimet përkatëse në preventivat e publikuara, duke përcaktuar këto të dhëna për të gjitha zonat që përfshihen në Bashkinë Kuçovë për shërbimin e pastrimit, duke përshkruar dhe përcaktuar në të gjitha modelet, elementët dhe zërat kryesorë që do t'i shërbejnë operatorit ekonomik për hartimin e ofertës së tij, si edhe duke përfshirë edhe shtesat në shëm dhe ish komunat.

Autoriteti kontraktor, në varësi të shërbimit që do të kryhet, referuar periudhës përkatëse në varësi edhe të zonave/njësive administrative që përfshihen në këtë shërbim si edhe të përfundimit të kontratave në vijim që janë për kryerjen e këtij shërbimi aktualisht, duhet të përcaktojë saktë zërat e punës, volume e tyre, e rrjedhimisht në varësi të tyre duhet të përcaktohet saktë edhe fondi limit, elementë këto shumë të rëndësishëm e të domosdoshëm për operatorin ekonomik në përgatitjen e ofertës së tij. Gjithashtu, edhe për analizën e kostos dhe modelin e kostos, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimet e duhura duke përcaktuar saktë analizat e modelet e analizës për secilën zonë, duke mos e lënë atë në përgjithësi dhe evazive.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Duke ju referuar kritereve të veçanta të kualifikimit pika 4 ku thuhet se: *Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e shërbimit, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit:*

e) Makineritë që duhet të disponojë shoqëria për realizimin e shërbimit, duhet të jenë të vit prodhimit minimalisht të v. 2003, duhet të jenë të plota dhe të pajisura me të gjithë aksesoret e nevojshëm e të mundshëm për të realizuar qëllimin dhe objektin e kontratave:

<i>Makine teknologjike me kapacitet min. 9-10 ton</i>	<i>2 cope</i>
<i>Mjet transporti vetëshkarkues \geq 9-10 tone</i>	<i>2 cope</i>
<i>Autobot uji min. çt</i>	<i>1 cope</i>

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 9-10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2003;*
- b) Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2003, jo më pak se 1 (një) copë.*
- c) Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj;*

me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo me te vogel se 5 m³. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2003. Jo më pak se 5 (pesë) cope

d) Makina teknologjike përfshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m³, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2003;

e) Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 7000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2003.

Ku bazohet AK, që përcakton vitin e prodhimit të mjeteve? Mbi cilin Ligj apo Vendim mbështete për të kërkuar vitin e prodhimit 2003? Ky është një kriter tepër diskriminues për OE pasi mjetet që qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë janë të paisur nga organet përkatëse më të gjitha dokumentacionin përfshirë edhe kontrollin teknik të tyre, konform rregullave dhe ligjeve të shtetit.

Jetet e viteve më të hershme nuk mund ti nxjerrë bashkia nga qarkullimi. Ato bëhen vetëm me vendim të Qeverisë. Bashkia duhet të kërkojë karakteristikat e tyre, tonazhin dhe modelet përkatëse për të kryer shërbimet.

Kërkojmë që ky kufizim të hiqet si tepër diskriminues nga kërkesat e veçanta.

Sa më sipër vërehet se ka një ndryshim midis sasisë së mjeteve të kërkuara dhe llojeve të tyre.

- i. Në tabelë kërkohej 2 kamiona vetëshkarkues, në shpjegimet e mëpohtme kërkohej 5 mjete vetëshkarkues.
- ii. Mjeti me platform nuk është kërkuar në tabelë si dhe nuk është as në specifikimet teknike dhe në preventive. Ky lloj mjeti është për të transportuar konteniere në parkun e OE për të kryer larjen e tyre, kurse AK ne specifikime dhe preventiv e ka larjen e konteniereve me mjet të veçantë teknologjik,
- iii. Autofshesa është kërkuar 4-6 m³, kurse në specifikimet teknike është kërkuar me kapacitet 1-1.5 m³
- iv. Në preventive është përcaktuar larja e konteniereve me mjet teknologjik, AK nuk e ka kërkuar si mjet.

Nga sa shikojmë këto kërkesa janë kopjuar nga një procedurë tjetër dhe nuk janë bërë ndryshimet përkatëse nga ana e Njesisë së Prokurimit. Marim shkas nga fakti që AK kërkon makinë me platformë, që nuk përkon me asnjë zë pune në preventive, sepse këto mjete përdoren për transport kontenieresh nga pikat e grumbullimit në parkun e sipërmarrësit për të larë kontenieret dhe anasjelltas, ndërsa AK larjen e konteniereve e ka kërkuar të kryhet në vend dhe me automjet të veçantë teknologjik.

Kërkojmë ndryshimin e këtyre kërkesave dhe përshtatjen e tyre me specifikimet teknike dhe preventivat.

III.3.1. Autoriteti kontraktor në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP sqaron se: “Në lidhje me vitin e prodhimit të mjeteve ju kujtojmë se procedura e rishpallur vjen si pasojë e procedurës së parë. KPP ka argumentuar se në lidhje me kërkimin e autoritetit kontraktor mbi vitin e prodhimit të mjeteve, KPP ka gjykuar se kërkesa e mësipërme është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, i shërben njëherazi jo vetëm proceseve të punës së parashikuar por njëkohësisht edhe ndikimit të tyre në mjedis. Në lidhje me mjetet më të vjetra ato dëmtojnë shëndetin, dëmtojnë ambientin në një kohë që raportet e makinerive me preventivin nuk janë të mbingarkuara. AK ashtu si çdo ent public në zbatim të strategjive sektoriale në fushën e transportit duhet të inkurajojë hyrjen në treg dhe përdorimin e mjeteve dhe teknologjive më të fundit/të reja që shërbejnë për përmirësimin e cilësisë së ambientit. Imponimi i ankimesit në procedurën e parë për të pranuar kërkesa të standarteve më të ulëta është i paargumentuar teknikisht dhe logjikisht nuk përbën avantazh më të mirë të proceseve të punës dhe teknologjisë. Për më tepër në kushtet e përgjithshme të kontratës është detyrimi i OE të paraqesë:

Detyrimet e përgjithshme të kontraktuesit

1. Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithsi.
2. Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

Në lidhje me numrin e mjeteve AK ka kërkuar [...]

Në lidhje me proceset e punës së mjeteve ato shërbejnë për transportimin e mbetjeve dhe kontenierëve, larja e kontenierëve është një proces i veçantë që nuk ka lidhje me proceset e punës të pretenduara nga ana juaj. Dhe në çdo rast OE do të kryejë shërbimin sipas specifikimeve dhe termave të parashikuara në këto DST.

III.3.2. Në dokumentat e tenderit, shtojca 7, pika 3.3. Kapaciteti teknik, pika 4 është përcaktuar kriteri:

Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e shërbimit, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

e) Makineritë që duhet të disponojë shoqëria për realizimin e shërbimit, duhet të jenë të vitit të prodhimit minimalisht të v. 2003, duhet të jenë të plota dhe të pajisura me të gjithë aksesoret e nevojshëm e të mundshëm për të realizuar qëllimin dhe objektin e kontratave:

<i>Makine teknologjike me kapacitet min. 9-10 ton</i>	<i>2 cope</i>
<i>Mjet transporti vetëshkarkues ≥ 9-10 tone</i>	<i>2 cope</i>
<i>Autobot uji min. 7t</i>	<i>1 cope</i>

- a) *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 9-10 ton, raport kompartimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2003;*

- b) *Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2003, jo më pak se **1 (një) copë**.*
- c) *Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo me te vogel se 5 m³. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2003. Jo më pak se **5 (pesë) copë**;*
- d) *Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m³, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2003;*
- e) *Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 7000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2003[...].*

III.3.3. Në lidhje me vitin e prodhimit të mjeteve, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, i shërben njëherazi jo vetëm proceseve të punës së parashikuar por njëkohësisht edhe ndikimit të tyre në mjedis. Për më tepër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se ky pretendim është arsyetuar në vendimin KPP 643/2017, datë 06.09.2017, duke përbërë kështu një gjë të gjykuar, aq më tepër në kushtet kur ankimes ishte i njëjti operator ekonomik.

Në këto kushte, këtë pretendim të operatorit ekonomik ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik nuk do ta marrë në shqyrtim, pasi ky pretendim është arsyetuar dhe shqyrtuar në vendimin e sipërcituar.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron në lidhje me këtë pikë.

III.3.4. Përsa i përket mjeteve, sasisë dhe llojit të tyre, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.3.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.3.6. Në nenin 28, pika 5, gërma “ç” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: ç) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën*”.

Gjithashtu, në sistemin e prokurimeve elektronike janë publikuar edhe preventivat përkatës me zërat dhe volumet e punës që duhen për këtë shërbim.

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit në lidhje me mjetet vetëshkarkuese dhe konkretisht numrit të tyre për mjetet vetëshkarkuese, sqarojmë se autoriteti kontraktor ka përcaktuar lloje të ndryshme mjetesh me të dhëna e karakteristika të ndryshme, si edhe me sasi të ndryshme. Konkretisht rezulton se në pikën e, ka kërkuar mjet transportues vetëshkarkues $\geq 9-10$ tone (2 copë), dhe në pikën “c” është kërkuar makinë vetëshkarkuese e hapur nga sipër me kapacitet transportues 3.5 tonë dhe volume vaskë jo më të vogël se 5 m³ (5 copë).

Sa më sipër, konstatohet se në këtë rast kemi të bëjmë me mjete me përmasa, volum, tonazh të ndryshëm, të kërkuara për kryerjen e punëve dhe shërbimeve të ndryshme, ndaj dhe numri apo sasia e tyre është e ndryshme, në varësi edhe të llojit të punës që do të kryejë. Në këtë rast, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim kanë si qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, nga ana e autoritetit kontraktor, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës. Në rastin konkret përcaktimi i këtij kriteri është në përputhje me volumet e punës dhe natyrën e shërbimit që do të kryhet.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3.8. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik për mjetin me platformë si edhe për mjetin teknologjik për larjen e kontenierëve, autoriteti kontraktor sqaron se *“në lidhje me proceset e punës ato shërbejnë për transportimin e mbetjeve dhe kontenierëve, larja e kontenierëve është një proces i veçantë që nuk ka lidhje me proceset e punës të pretenduara nga ana juaj. Dhe në çdo rast OE do të kryejë shërbimin sipas specifikimeve dhe termave të parashikuara në këto DST”*.

Mjeti me platformë është përcaktuar në dokumentat e tenderit që do të shërbejë për kryerjen e funksionit të ngarkimit dhe shkarkimit të kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, pra e ka të përcaktuar qëllimin për të cilin është kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe nuk ka lidhje me faktin e larjes ose të kontenierëve. Përcaktimi i këtij kriteri vjen në përputhje me zërat dhe volumet e punës që do të kryhen dhe lidhet me procese pune të përcaktuara në specifikimet teknike.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për mjetin me platformë nuk qëndron.

III.3.9. Përsa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues për mjetin teknologjik për larjen e kontenierëve, konstatojmë se në dokumentat e tenderit, në specifikimet teknike janë përcaktuar preventivat përkatës ku evidentohet zëri “larja e kontenierëve me mjet teknologjik”.

Në specifikimet teknike, është përcaktuar se: *“Për të patur një standart të mirë në shërbimin e pastrimit mendojmë që të futim për herë të parë edhe një shërbim të ri, atë të larjes së kontenierëve me mjet teknologjik. Ky shërbim i ri është i nevojshëm, jo vetëm për të patur kontenierë të pastër, që nuk vijnë erë të rëndë e të keqe nga prania e mbeturinave organike që ngjiten në fund të kontenierit, por edhe për mbrojtur kontenierët nga korodimi i shpejtë dhe ulja e jetëgjatësisë së tyre. Ky shërbim i ri do të ofrohet 48 ditë në vit, dmth 4 ditë në muaj.*

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, referuar zërave të punës, shërbimit që do të kryhet, autoriteti kontraktor ka përcaktuar edhe mjetet të cilat janë të përcaktuara për të kryer një qëllim të caktuar, rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3.10. Përsa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues në lidhje me mjetin autofshesë, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se në shtojcën 7 është përcaktuar kriteri: *“Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m³, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2003”.*

Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në specifikimet teknike nuk konstatohet ndonjë kriter për mjetin autofshesë me përmasa 1-1.5 m³. Përsa kohë që pretendimi i operatorit ekonomik ankimues lidhet vetëm me kapacitetin e mjetit autofshesë, KPP gjykon se pas verifikimeve të kryera, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor në lidhje me mjetet është në proporcion me volumin dhe natyën e kontratës dhe i shërbejnë proceseve të punës së parashikuar, rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se *Bashkia është shprehur në kërkesa e veçanta se:*

- *Mjetet duhet të jenë në pronësi dhe të jenë të shënuara në regjistra publikë. OE duhet të paraqesë dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit taksat.*

- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore të blerjes.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- *Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shit-blerje ose kontrata dhurimi).*

Nga kriteret e kopjuara në procedurat e tjera, AK është e paqartë për mase si do të paraqiten mjetet për këtë procedurë, edhe në vendimin e KPP 643/201ç, por edhe në VKM e Prokurimeve shrehet se AK duhet të jetë e qartë në kriteret që kërkon për të vërtetuar kapacitete teknike të operatorëve. Këto kritere që kanë kopjuar, janë konfuze dhe shumënagjërruese. OE nuk e di se si duhet të vërtetojë kapacitetin teknik, që zotëron, si dhe sasië e këtyre mjeteve, që duhet të disponojë OE. AK ka parashikuar vetëm që mjetet të jenë në pronësi dhe më poshtë shprehet me pira.

Kërkojmë që AK të jetë konkret, për sasinë e mjeteve dhe se si do ta vërtetojë OE posedimin e mjeteve (me pira, me kontratë pronësie, me Leasing etj).

AK për disponueshmërinë e konteniereve metalike është shumë e saktë për kërkesat që parashtron për OE. Pse dhe për mjetet nuk është vepruar kështu?

Kërkojmë që kjo kërkesë për mjetet të rregullohet njësoj si për kontenieret.

III.4.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 7, pika 3.3. Kapaciteti teknik, pika 4, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin: “[...]

- *Mjetet duhet të jenë në pronësi dhe të jenë të shënuara në regjistra publikë. OE duhet të paraqesë dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit taksat.*
- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore të blerjes.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- *Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shit-blerje ose kontrata dhurimi)”.*

Gjithashtu në gërmën “a”, pas pikës 8 të dokumentave të tenderit është përcaktuar kriteri:

a) Për mjetet në pronësi/qera apo të porositura, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit për të cilën është shpallur Fitues, si dhe të deklarojë adresën e saktë të vendndodhjes së mjeteve në Shqipëri, me qëllim verifikimin e tyre. Në rast se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon mjetet brenda afatit të sipërcituar, do të s’kualifikohet dhe Autoriteti Kontraktor do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje”.

III.4.2. Në shtojcën 7 të dokumentave të tenderit, pika 1, Kapaciteti teknik është përcaktuar kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 120 (njëqind e njezete) konteniere metalike ose zgjidhje ekuivalente me kapacitet minimal sipas sasise ditore qe do te evadohet, të jenë të papërdorura apo të paricikluara.

Disponueshmëria e tyre duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë:

- a) *Kontenieret në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie original ose kopje të noterizuar si dhe me faturat tatimore të blerjes.*
- b) *Kontenieret e marra me qira financiare (leasing) apo të porositura duhet të shoqërohen me porosine (original ose kopje e noterizuar). Kontrata duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes /afatin e ekzekutimit të porosisë (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi) si dhe faturat tatimore/ e transfertë bankarë për cdo porosi të kryer për sasinë minimale të kërkuar gjëndje*
- c) *Për Kontejnerët në pronësi, ose te porositur, Operatori ekonomik duhet të lejojë AK të kryejë verifikimin fizik te min. 30 % te sasise se kerkuar te konteniereve përgjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Në rast se Operatori ekonomik nuk i disponon kontenierët brenda periudhes së sipërcituar, do të s'kualifikohet.*
- d) *OE nuk duhet ti kete ne perdorim/ instaluara keto konteniere ne funksion te realizimit te nje kontrate ne fuqi.*
- e) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e konteniereve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit, shoqeruar me specifikimet teknike dhe pamje fotografike nga vendodhja e tyre, si dhe adresen e vendodhjes se tyre. Vendodhja e tyre duhet te jetë ne një nga ambientet ku OE ushtron aktivitetin tregtar (magazinë e vetë OE, magazina me qira, apo dhënie në ruatje tek të tretët (në këtë rast duhet ta konfirmojë me kontratë depozitimi dhe faturat e pagesës).*

III.4.3. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues, si edhe në informacionin depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor sqaron se: “Ju kërkoni sqarim për llojin e dokumentave të pronësisë. Bazuar në kodin civil dokumenti është çdo lloj dokumenti që vërteton transferimin e të drejtave reale për posedim dhe gëzim të sendit. AK ka përcaktuar qartë llojin e dokumentave bazuar në standartet kombëtare të kontabilitetit dokumenta që ruhen përgjithmonë janë ato që përcaktohen në këto kërkesa që ka vendosur AK. Në lidhje me pretendimin tuaj se në DT kërkohen mjete me qera ju sqarojmë se bëhet fjalë për një gabim material i cili korrigjohet si më poshtë:

- i. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe të dhëna të tjera”.*

III.4.4. Në lidhje me saktësimin që ka bërë autoriteti kontraktor përsa i përket kriterit të përcaktuar për fotot, nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e këtij pretendim me arsyetimin se është bërë një gabim material duke e korrigjuar atë, por që ky fakt nuk është reflektuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e autoritetit kontraktor (shtojcë e dokumenteve të procedurës së prokurimit) në lidhje me vendimarrjen e AK.

Megjithatë, Komisioni i Prokurimit Publik nuk mund të anashkalojë faktin se pretendimi i mësipërm është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor dhe në lidhje me këtë të fundit nuk ka më objekt ankimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, por në zbatimin e këtij vendimi të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor, krahas konstatimeve të vendimarrjes së K.P.P. duhet të pasqyrojë njëherazi edhe ndryshimet e dokumenteve të procedurës së prokurimit për aq sa është pranuar prej autoritetit kontraktor.

III.4.5. Nga ana tjetër, referuar dokumentave të tenderit dhe kritereve të përcaktuara në shtojcën 7, në lidhje me mjetet autoriteti kontraktor ka përcaktuar në një pikë që mjetet duhet të jenë në pronësi dhe në një pikë tjetër ka përcaktuar “*mjetet në pronësi/qera apo të porositura*” duke nënkuptuar që mjetet mund të jenë në një nga këto forma.

III.4.6. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me përcaktimin e kritereve për mjetet ashtu siç janë përcaktuar tek kontenierët, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se jemi para dy rasteve të ndryshme, e rrjedhimisht edhe kërkesat e kriteret nuk mund të jenë të njëjta.

Në rastin e kontenierëve sqarojmë se kemi të bëjmë me mall, dhe disponimi i tyre mund të bëhet në një nga mënyrat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, dhe disponimi i tyre vërtetohet në formë dhe kohë tjetër, ndërsa në rastin e mjeteve kemi të bëjmë me një element të rëndësishëm që nuk është mall por që janë të regjistruar në regjistra publikë dhe të cilat janë të pajisura me një sërë dokumentacioni që gjendet pranë zyrave të organeve të transportit rrugor.

Pretendimi i operatorit ekonomik për unifikim të kritereve të përcaktuara për mjetet me ato të përcaktuara për kontenierët nuk qëndron.

III.4.7. Referuar dokumentave standard të tenderit të hartuara dhe të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, si edhe në legjislacionin përkatës në fuqi, disponimi vërtetohet jo vetëm nëpërmjet pronësisë së një mjeti por edhe nëpërmjet formave të tjera ligjore (qera etj).

Sa më sipër në kushtet kur disponimi ka disa forma ligjore me të cilat mund të njihet, rekomandohet autoriteti kontraktor të bëjë modifikimin duke qartësuar, unifikuar kriterin në lidhje me mjetet duke përcaktuar të gjitha format ligjore që vërtetojnë disponimin e mjetit (pronësi/qera).

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se “*Në pikat 5 dhe 6 të kritereve të veçanta thuhet se: Operoret ekonomike ofertues qe kane patur marrëdhënie kontraktuale te mëparshme me ish njësitë vendore qe përbëjnë Bashkinë Kuçovë dhe te cilët kane rezultuar me mos përmbushje te suksesshme te objektit dhe detyrimeve përkatëse te kontratës, do te s’kualifikohen. Operatori ekonomik ofertues nuk duhet te ketë detyrime te papaguara vendore, detyrime te ngarkuara nga organet kompetente audituese apo detyrime te ngarkuar nga organe te tjera ne favor te Bashkisë Kuçovë dhe te Njësi Administrative (ish Komuna qe i janë bashkuar Bashkise Kuçovë). Mos përmbushja e këtij kriteri është shkak s kualifikimi. Ne rastin e bashkimit te operoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.*

AK në kriteret e mësipërme nuk ka kërkuar dokumente apo vërtetime se si OE do të vërtetojnë që nuk kanë detyrime apo mospërmbushje të kontratave. Si do të faktohen Këto detyrime?

Kërkojmë që këto kritere të riformulohen dhe të shprehet konkretisht për vërtetimet që duhet të paraqesin OE në përmbushjen e tyre”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimes sqaron se: *“në lidhje me këtë pikë kuptohet fare qartë që çdo document vërtetues lëshuar nga institucioni i përmendur në këtë kërkesë do të përbëjë document të vlefshëm për të dëshmuar situatën e mësipërme ose ky vlerësim mund të bëhet ex officio nga vetë AK për shkak të dijenisë së fakteve. Për sa më sipër OE duhet të paraqesin një dëshmi të lëshuar nga AK, ose ky i fundit ruan të drejtën të bëjë vlerësim ex officio për shkak të informacionit që disponon”*.

III.5.2. Në dokumentat e tenderit Shtojca 7, pika 3.3. Kapaciteti teknik, pikat 5 dhe 6, nga autoriteti kontraktor janë përcaktuar kriteret si më poshtë vijon: 5. *Operatorët ekonomikë ofertues që kanë patur marrëdhënie kontraktuale të mëparshme me ish njësitë vendore që përbëjnë Bashkinë Kuçovë dhe të cilët kanë rezultuar me mos përmbushje të suksesshme të objektit dhe detyrimeve përkatëse të kontratës , do të s’kualifikohen.*

6. *Operatori ekonomik ofertues nuk duhet të ketë detyrime të papaguara vendore, detyrime të ngarkuara nga organet kompetente audituese apo detyrime të ngarkuar nga organe të tjera në favor të Bashkisë Kuçovë dhe të Njësisë Administrative (ish Komuna që i janë bashkuar Bashkisë Kuçovë). Mos përmbushja e këtij kriteri është shkak skualifikimi. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.*

III.5.3. Në nenin 57 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se : *“ Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:*

- *sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;*
- *përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti);*
- *përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;*
- *hartimin e urdhrit të prokurimit;*
- *përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;*
- *hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;*
- *administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;*
- *llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti.”*

Në nenin 46 të ligjit për prokurimin publik përcaktohet se: *“Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”*.

III.5.4. Në lidhje me kërkimin e mësipërm të autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar përcaktimit të kriterëve të mësipërme, nga ana e autoritetit kontraktor, nuk është parashikuar në mënyrë të qartë dhe eksplicide kërkesa konkrete apo dokumenti me anë të të cilit do të duhen të vërtetohen kërkesat e përcaktuara.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, njësia e prokurimit duhet të hartojë dokumentet e procedurës në përputhje me parashikimet e nenit 57 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik” të ndryshuar, duke parashikuar në mënyrë të qartë të gjitha kërkesat dhe kriteret të cilat duhet të plotësohen nga ana e operatorëve ekonomikë të interesuar për një procedurë prokurimi, ashtu edhe do të kihen parasysh nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të ofertave duke mos krijuar konfuzion dhe paqartësi tek ky i fundit gjatë këtij procesi.

Pra, hartimi i kriterëve të qarta ka për qëllim të mos krijojë pengesa, konfuzion për operatorët ekonomikë gjatë momentit të hartimit të ofertës ekonomike, por mos të krijojë paqartësi edhe në punën e komisionit të vlerësimit të ofertave gjatë punës së tij të vlerësimit të operatorëve ekonomikë. KPP gjykon se, nuk është në frymën e legjislacionin për prokurimin publik, i cili kërkon që të përcaktohen saktë termat apo specifikimet teknike dhe në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara, ndaj kërkesat dhe kriteret duhet të jenë të qarta, të sakta e të kuptueshme që most ë lenë vend për keqinterpretime, pengesa e konfuzion.

Edhe vetë autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues e ka lënë evazive plotësimin e këtyre kriterëve nga ana e operatorëve ekonomikë duke e lënë të hapur ose plotësimin nga ana e operatorëve ekonomikë me çfarëdolloj dokumentacioni të lëshuar nga organet e përmendura, ose do të bëhet nga vetë autoriteti kontraktor, duke krijuar paqartësi dhe për mënyrën se si do të veprohet në këtë rast në procesin e vlerësimit të ofertave.

Gjithashtu, në përcaktimin e dokumentacionit që duhet të plotësohet në këtë rast nga ana e operatorëve ekonomikë, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor në këtë rast duhet të ketë parasysh edhe faktin se shumë nga këto organe nuk ekzistojnë më si institucione për shkak të ndarjes së re territoriale, dhe si të tilla është e pamundur marrja e një dokumentacioni të tillë.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të bëjë riformulimin e këtyre kriterëve, modifikimin e duhur e të nevojshëm të kriterëve të mësipërme duke përcaktuar saktë dhe qartë dokumentacionin që duhet të paraqitet nga ana e operatorëve ekonomikë dhe me anë të të cilit do të bëhet e mundur vërtetësia e kriterëve të cituara.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Bashkia ka kërkuar çertifikata ISO 9001 14001 18001, por nuk ka kërkuar asnjë leje apo liçensë profesionale të OE, të cilat janë ndër pikat kryesore të këtyre çertifikimeve. Sugjerojmë që të shtohen liçencat profesionale në kriteret e veçanta të kualifikimit. OE fillimisht duhet të jenë të liçensuar në fushat përkatëse, në të cialt kryejnë biznesin dhe pastaj të çertifikohen nga organet e huaja.*

Kërkojmë që të vendosen lejet dhe liçencat profesionale përkatëse për shërbimin, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në dokumentat e tenderit shtojca 7, pika 3.3. Kapaciteti teknik, pika 7, është përcaktuar kriteri: “*OE duhet të jetë i pajisur me certifikatë të vlefshme ISO 9001:2015 (ose ekuivalent) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme) (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikaten ISO)/ ISO 14001:2015 (ose ekuivalent) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme) (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikaten ISO), dhe OHSAS 18001:2007 ose ekuivalent për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme)*

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikaten BS OHSAS). Certifikatat duhet të jenë të shoqëruara me dokumentacionin e akreditimit të organit certifikues si dhe programin e akreditimit. OE është përgjegjës për të dëshmuar se në momentin e akreditimit certifikimit, njësia certifikuese ka qene e akredituar për standardin e lëshuar/certifikuar.

OE duhet te paraqesë edhe raportet e periodes te monitorimit për te dëshmuar vijueshmërinë e përputhshmërisë me standartet e kërkuara”.

III.6.2. Në lidhje me këtë pretendim, KPP konstaton se ankimuesi ka parashtruar pretendime në lidhje me shtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi veçanërisht në drejtim të përcaktimit në këto të fundit të kërkesave lidhur me licencat e shoqërive pjesëmarrëse për zbatimin e kontratës. Në lidhje me këtë pretendim, sqarojmë se në vendimin KPP 643/2017, datë 06.09.2017 në pikën III.1. të pjesës Arsyetoi, Komisioni i Prokurimit Publik e ka sqaruar këtë fakt, duke përbërë kështu një gjë të gjykuar, aq më tepër në kushtet kur ankimues ishte i njëjti operator ekonomik.

Në këto kushte, këtë pretendim të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik nuk do ta marrë në shqyrtim, pasi ky pretendim është arsyetuar dhe shqyrtuar në vendimin e sipërcituar.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron në lidhje me këtë pikë.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Përsa i përket kërkesës që, OE duhet të dëshmojë që ka aftësi (çertifikata lëshuar nga një organ i akredituar), të përpunojë/ identifikojë/ trajtojë mbetjet metalike në fund të ciklit të jetës në përputhje me standartin EU 333/2011 (2008/98/EC) ose ekuivalent lëshuar nga agjensi certifikimi (Në rastin e bashkimit të OE, secili duhet të disponojë këtë certifikatë).

Së pari, nëse do ti referohemi rregulloreve, direktivave dhe udhëzimeve që dalin nga Parlamenti European, në Bruksel, atëhere gjëja e parë që do të kemi parasysh është që këto aplikohen për çdo vend anëtar i Bashkimit European. Parlamenti European për ta theksuar këtë gjë, në fund të çdo dokumenti që harton dhe publikon e specifikon këtë gjë.

Vetëm duke u nisur nga kjo specifikë, duhet të pranojmë që Shqipëria dhe çdo subjekt shqiptar nuk mund ti aplikojë këto direktiva, rregullore apo udhëzime, sepse janë hartuar vetëm për anëtarët e BE.

Së dyti, kjo rregullore u referohet atyre subjekteve që do të eksportojnë skrap metali prej alumini dhe hekuri në një nga vendet e BE dhe kjo procedurë prokurimi ka tjetër object. AK në DST kërkon që të bëhet ndarja në burim dhe sistemimi i mbeturinave në fushën e grumbullimit, pra ndarja e mbeturinave për riciklim dhe jo për të eksportuar skrap metali apo alumini në vendet e BE.

Pra nëse një kompani do të eksportojë skrap metali apo alumini si lëndë të parë për industrinë, duhet të përmbushë këto kriterë të përcaktuar në rregulloren nr. 333/2011. Nëse i plotëson këto, atëhere ka të drejtë të eksportojë.

Prandaj e quajmë të pavend dhe absolutisht në kundërshtim me vetë rregulloren, aplikimin e një subjekti shqiptar të këtyre kriterëve të parashtruara në këtë rregullore.

Kërkojmë që ky kriter të hiqet.

III.7.1. Në dokumentat e tenderit në shtojcën 7, pika 3.3. Kapaciteti teknik, pika 8, është përcaktuar kriteri: *“OE duhet të dëshmojë se ka aftësi (certifikatë lëshuar nga një organ i akredituar) të përpunojë/ identifikojë/ trajtojë mbetjet metalike në fund të ciklit të jetës në përputhje me standartin EU 333/2011 (20008/98/EC) ose ekuivalent, lëshuar nga agjenci certifikimi. (Në rastin e bashkimit të OE secili duhet të disponojë këtë certifikatë).*

III.7.2. Autoriteti kontraktor në informacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, sqaron se: *“Ju i referoheni vetëm direktivës së BE-së, ndërkohë që ne si AK kemi parashikuar edhe rregullore teknike alternative duke parashikuar fjalën ose ekuivalent (pra certifikata ekuivalente). Argumentimi që ju bëni është i pavend pasi aktivitetet dhe proceset që trajton kjo rregullore apo rregullore ekuivalente nuk ka të bëjë me ndërtim fonderie, por me kapacitetet dhe aftësitë tekniko profesionale të operatorit ekonomik për të trajtuar evadimin e mbetjeve elektroshtëpiake, mbetjet metalike/hekuri apo mjete të rënda në mënyrë profesionale por edhe aftësitë për të identifikuar këto mbetje dhe fazën e jetës së tyre, në mënyrë që të garantohet një ambient i pastër dhe që nuk dëmton shëndetin e banorëve të kësaj bashkie”.*

III.7.3. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe gërma “b” e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

a) *kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;*

b) *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

III.7.4. Në nenin 46, pika 2 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. [...]”.*

III.7.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 30 “Kërkesat e cilësisë”, përcaktohet se:

“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.

III.7.6. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se

zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.7.7. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimes, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet edhe në faktin në rast se kriteri i mësipërm është në proporcion *me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet* në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

Në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, KPP vlerëson të sqarojë se referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, synimi bazë i autoritetit kontraktor me anë të dokumentacionit të kërkuar është vërtetimi se operatorët ekonomikë pjesëmarrës përmbushin kapacitetin teknik në kuptim të nenit 46 pika 1 gërma “c” të *lex specialis*. Referuar dispozitës së sipërcituar, qëllimi i kërimit të dokumentacionit në përmbushje të kapacitetit teknik dhe financiar lidhet *stricto sensu* me qëllimin e vërtetimit se operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë kapacitetet teknike për të përmbushur kontratën. Referuar natyrës së procedurës së prokurimit objekt ankimi, vëllimit të kontratës, mënyrës së financimit të kontratës si edhe mekanizmave të tjerë me anë të të cilave autoriteti kontraktor siguron plotësimin e kapacitetit teknik, kërkitimi i mësipërm që OE duhet të dëshmojë se ka aftësi (certifikatë lëshuar nga një organ i akredituar) të përpunojë/ identifikojë/ trajtojë mbetjet metalike në fund të ciklit të jetës në përputhje me standartin EU 333/2011 (20008/98/EC) ose ekuivalent, lëshuar nga agjenci certifikimi, është një kërkesë e cila tejkalon synimin e autoritetit kontraktor si edhe njëherazi nuk është në përpjestim me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Në rastin konkret procedura e prokurimit objekt shqyrtimi është “Shërbimi i pastrimit, mbledhjen dhe transportimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçovë”, ndërkohë që në përcaktimin e kriterit të mësipërm, autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik të dëshmojë se ka aftësi të përpunojë/identifikojë/trajtojë mbetjet metalik në fund të ciklit të jetës në përputhje me standartin EU 333/2011 (20008/98/EC) ose ekuivalente lëshuar nga agjenci certifikimi.

Gjithashtu sqarojmë se kjo direktivë europiane në fund të rregullores ka të përcaktuar qartë dhe shprehimisht se: “*Kjo rregullore është e detyrueshme në tërësinë e saj dhe është e zbatueshme drejtpërdrejtë në të gjitha Shtetet Anëtare*”, duke përjashtuar aplikimin e saj për vendin tonë i cili ende nuk është shtet anëtar i BE-së.

Autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë kriterë të sakta e të qartë dhe jo evazive dhe pakuptim, aq më tepër jo në proporcion dhe përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Autoriteti kontraktor kërkon certifikatë për përpunim/identifikim/trajtim të mbetjeve metalike në fund të ciklit të jetës së tyre në përputhje me standartin EU, së pari në kushtet kur objekti i prokurimit ka të bëjë me shërbim pastrimi dhe jo me përpunim e trajtim të mbetjeve metalike, si edhe së dyti kërkon një certifikatë për një direktivë që është e aplikueshme vetëm për shtetet anëtare të BE-së. Komisioni i Prokurimit Publik, bazuar edhe në dokumentacionin e kësaj procedure prokurimi, specifikimeve teknike etj, gjykon se kërkesa për këtë kriter është e ekzagjeruar dhe jo në

përpjesëtim të drejtë me volumin e kontratës dhe objektin e prokurimit, duke vlerësuar se nuk është e nevojshme kërkesa për paraqitjen e një dokumenti të tillë.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin duke hequr kriteret diskriminuese dhe jo në proporcion me natyrën dhe objektin e kontratës.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se “Përsa i përket konteniereve AK është shprehur në DST se:

Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 120 (njëqind e njetete) konteniere metalike ose zgjidhje ekuivalente me kapacitet minimal sipas sasise ditore që do të evadohet, të jenë të përdorura apo të paricikluara.

Disponueshmëria e tyre duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kontenieret në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie original ose kopje të noterizuar si dhe me faturat tatimore të blerjes.*
- b) Kontenieret e marra me qira financiare (leasing) apo të porositura duhet të shoqërohen me porosinë (original ose kopje e noterizuar). Kontrata duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes /afatin e ekzekutimit të porosisë (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi) si dhe faturat tatimore/ e transfertë bankare për çdo porosi të kryer për sasinë minimale të kërkuar gjëndje.*
- c) Për Kontejnerët në pronësi, ose të porositur, Operatori ekonomik duhet të lejojë AK të kryejë verifikimin fizik të min. 30 % të sasise së kërkuar të konteniereve përgjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Në rast se Operatori ekonomik nuk i disponon kontenierët brenda periudhës së sipërcituar, do të s'kualifikohet.*
- d) OE nuk duhet të ketë në përdorim/ instaluar këto konteniere në funksion të realizimit të një kontrate në fuqi.*
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e konteniereve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe pamje fotografike nga vendodhja e tyre, si dhe adresën e vendodhjes së tyre. Vendodhja e tyre duhet të jetë në një nga ambientet ku OE ushtron aktivitetin tregtar (magazinë e vetë OE, magazina me qira, apo dhënie në ruatje tek të tretët (në këtë rast duhet ta konfirmojë me kontratë depozitimi dhe faturat e pagesës)*

Përsa i përket pikës (d) të këtij kriteri, theksojmë se është diskriminuese dhe aspak i nevojshëm, sepse nëse OE nuk mund të nxjerrim jashtë përdorimit mjete të reja dhe pajisjet sa herë që Autoritetet zhvillojnë një procedurë dhe në të fillojnë kontratat me pajisja të reja. Kërkojmë që ky kriter të hiqet dhe të modifikohet.

III.8.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7, pika 3.3. Kapaciteti teknik, pika 1, është përcaktuar kriteri: “Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 120 (njëqind e njetete) konteniere metalike ose zgjidhje ekuivalente me kapacitet minimal sipas sasise ditore që do të evadohet, të jenë të përdorura apo të paricikluara.

Disponueshmëria e tyre duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kontenieret në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar si dhe me faturat tatimore të blerjes.
- b) Kontenieret e marra me qira financiare (leasing) apo të porositura duhet të shoqërohen me porosinë (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes /afatin e ekzekutimit të porosisë (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi) si dhe faturat tatimore/ e transfer të bankarë për çdo porosi të kryer për sasinë minimale të kërkuar gjëndje.
- c) Për Kontejnerët në pronësi, ose të porositur, Operatori ekonomik duhet të lejojë AK të kryejë verifikimin fizik të min. 30 % të sasise së kërkuar të konteniereve përgjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Në rast se Operatori ekonomik nuk i disponon kontenierët brenda periudhës së sipërcituar, do të s'kualifikohet.
- d) OE nuk duhet të ketë në përdorim/instaluar këto konteniere në funksion të realizimit të një kontrate në fuqi.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e konteniereve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe pamje fotografike nga vendodhja e tyre, si dhe adresën e vendodhjes së tyre. Vendodhja e tyre duhet të jetë në një nga ambientet ku OE ushtron aktivitetin tregtar (magazinë e vetë OE, magazina me qira, apo dhënie në ruatje tek të tretët (në këtë rast duhet ta konfirmojë me kontratë depozitimi dhe faturat e pagesës)).

III.8.2. Autoriteti kontraktor në dokumentacionin e paraqitur sqaron se:

“Operatori ekonomik imponon se do të përfshijë mjetet e përdorura, imponon në mënyrë të padrejtë autoritetin kontraktor që të përdore mjete të vjetra, të përdorura të cilat janë të amortizuara tërësisht në një kohë që kostot e këtij shërbimi planifikojnë edhe rigjenerimin e tyre, është qëllim i autoritetit kontraktor dhe madje edhe i vetë kushteve të përgjithshme të kontratës nëni 7 i së cilës parashikon që: “kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta”. Kujtojmë se këto kushte janë parim i pranuar ndërkombëtar që rrjedh nga parimi i konkurrueshmërisë së vlerave e produkteve që sjellin zhvillim dhe përmirësim të kushteve të jetesës së komuniteteve, me shumën e kërkuar në këtë shërbim AK kërkon standartet më të mira të mundshme dhe më të avancuara të reja”.

III.8.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për të njohur gjendjen e operatorëve ekonomikë, kapacitetet ekonomike, financiare, teknike e ligjore, me qëllim realizimin me sukses të kontratës, dhe nga ana tjetër përcaktimi dhe vendosja e kriterëve duhet të bëhet në përpjesëtim dhe në proporcion me natyrën dhe objektin e prokurimit.

Referuar sa më sipër, duke parë dhe vlerësuar në tërësi kriterin në lidhje me kontenierët, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se kriteri i vendosur dhe përcaktuar në këtë mënyrë nënkupton faktin që për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që mjetet nuk duhet të jenë në përdorim apo të instaluar në funksion të ndonjë kontrate tjetër që është në fuqi aktualisht dhe operatori ekonomik është në proces të realizimit të saj, fakt i cili nuk krijon sigurinë e autoritetit kontraktor Bashkia Kuçovë për realizimin në kohë e me sukses të kontratës.

Nga ana tjetër, referuar edhe sqarimit të autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se është ky i fundit organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere në lidhje me kontenierët në rastin konkret duke i kërkuar ato të mos jenë të jenë të angazhuara në kontrata të tjera aktuale pra që janë duke u ekzekutuar, pasi do të cënonin këtë proces që zhvillohet nga Bashkia Kuçovë, kriter ky që është në proporcion dhe në përpjesëtim me natyrën e kontratës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.9. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes se *“Përsa i përket pikës që: OE duhet të plotësojë sipas kërkesave specifike të përcaktuara në Shtojcën Ekstra, Çertifikata për Oferta të Pavarura, konstatojmë se ne nuk kemi hasur në asnjë procedurë këtë shtojcë dhe nuk ekziston në DST që shpall APP. Kjo shtojcë plotësohet nga shtojca dhe deklaratat, të cilat janë në DST.*

Kërkojmë që kjo shtojcë të hiqet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.9.1. Në dokumentat e tenderit, është publikuar një Shtojcë e veçantë *“Çertifikata për ofertë të pavarur”*.

III.9.2. Në dokumentat e tenderit, seksioni Udhëzime për operatorët ekonomikë përcaktohet se: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”*.

Në nenin 13 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Agjencia e Prokurimit Publik:[...] ç) harton dokumentet standarde të tenderit, që do të përdoren në procedurat e prokurimit, sipas rregullave të prokurimit publik”*.

Në nenin 41 po këtu përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike”*.

Në nenin 10 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Dokumentet standarde të tenderit APP-ja përgatit formatin e dokumenteve standarde të tenderit, që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit. Këto dokumente japin informacion që ka lidhje me objektin e kontratës dhe llojin e procedurës, i cili plotësohet, në çdo rast, nga autoritetet kontraktore. Gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor përdor dokumentet standarde sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike ose kundrejt pagesës, në rastet kur vlerësohet nga autoriteti kontraktor në procedurat e prokurimit që nuk kërkojnë njoftim publik, sipas nenit 38 të LPP”*.

Në nenin 61 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi.*

Në hartimin e dokumenteve të tenderit njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit. 2. Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet”.

III.9.3. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, sqaron se autoriteti kontraktor duhet të përdorë gjatë publikimit të një procedure prokurimi, dokumentat standarte të tenderit, të hartuara dhe të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, si edhe setin e atyre dokumentave të cilat janë në fuqi. Nuk mund dhe nuk duhet që asnjë autoritet kontraktor të ndërhyjë në këto dokumenta duke bërë ndryshime apo shtesa të shtojcave të ndryshme duke i bërë pjesë të këtyre dokumentave të cilat janë të hartuara nga një organ i specializuar dhe i ngarkuar me ligj.

Në rastin konkret konstatojmë se në kundërshtim me sa më sipër, autoriteti kontraktor ka bërë publikimin e dokumentave të tenderit, duke shtuar në setin standard të dokumentave të tenderit, një shtojcë të veçantë dhe e ka bërë pjesë të këtij seti, shtojcë kjo e hartuar prej vetë autoritetit kontraktor, duke u bërë si pjesë detyruese me këto dokumenta, si edhe e cila nuk është e hartuar apo miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, si organi që ka këtë përgjegjësi ligjore.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të bëjë publikimin e dokumentave të tenderit, bazuar vetëm në dokumentat standarte të tenderit, dhe duhet të përcaktojë e vendosë kritere, në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës, si edhe të tilla që të mos jenë diskriminuese dhe të mos pengojnë konkurrencën dhe kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Rrjedhimisht, sa më sipër analizuar, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e dokumentave të tenderit, duke hequr këtë kriter.

III.10. Referuar sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, në përfundim të shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, referuar arsytimit të vendimit, krahas pranimi të modifikimit të disa prej kritereve të veçanta të kualifikimit, njëherazi është vendosur edhe pranimi i ndryshimit të përlllogaritjes së fondit limit të kësaj procedure prokurimi.

Në nenin 64, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës; b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin.

Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj; c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës; ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese”.

Sa më sipër arsyetuar, KPP gjykon se, për shkak të shkeljeve të konstatuara, autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë konstatimet e mësipërme, duke modifikuar njëherazi edhe kriteret e veçanta të kualifikimit, konstatuar në këtë vendim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Higjena” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Shërbim i pastrimit, mbledhjen dhe transportimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçovë” me Nr. REF 29588-10-12-2017, me fond limit 128.883.334 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 04.11.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kuçovë.
2. Të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rishpalljen e saj autoriteti kontraktor të hartojë d në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryer.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Higjena” sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1622 Protokolli

Datë 27.10.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha